



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .07.2024

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga z. A.S.
Adresa: _____ Ruga e Dibrës nr 370
E-mail :

TIRANË

I nderuar z. S.

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 1107 prot datë 02.07.2024 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës në referencë të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, kërkohet informacion lidhur me personat që gjatë muajit maj të vitit 2023 kanë marrë dokumentacionin kopje e njësuar e dosjes hetimore 12389-A të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me nr vendimi 113 datë 29.12.1982 si edhe dosjen gjyqësore së bashku me vendimin e Gjykatës Kukës për dënimin e shtetasve, R.E., B.Gj., Sh.Gj., Xh.Gj., A.Gj., Sh.D., M.S. dhe H.V., dokumente të cilat janë paraqitur në një kronikë të televizionit ABC NEWS në datat 12-13 maj 2023, sipas informacionit të dërguar nga struktura që ka trajtuar praktikën në periudhën e sipërcituar, ju informojmë se:

Pranë Autoritetit, është depozituar kërkesa e paraqitur nga z. N.N., drejtor i medias Publik Live, nr. 643 prot., datë 03.04.2023 dhe për plotësim dokumentacioni nr. 643/1 prot, datë 27.04.2023 nga z. E.Gj. për qëllime mediatike, në lidhje me një reportazh, me objekt informimi mbi dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit në lidhje me A.Gj. dhe B.Gj. Kërkuesit i janë vendosur në dispozicion me Vendim nr. 307 datë 8.05.2023.

Këtë vendim ju mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen zyrtare të Autoritetit.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti